REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 10021/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KEK- KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit me numër: KEK-20-3036-1-1-1

Numri i brendshëm: KEKO-20-237-111

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me llamarinë, gypa dhe bulona, LOT 1 - Furnizim me gypa rrethor dhe katror të çelikut**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Fehmi Raçi B.I. – emri tregtar: N.T.P. "Euro-Commerce"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bill Klinton, nr. 294.
(Adresa)

Prishtina — 10000
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 702 882
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Agon Raçi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nteurocommerce@gmail.com
(Adresa elektronike)

23 Nëntor 2020
(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

NDËRMARRJA "REGT EKSPORT-IMPORT" EURO COMMERC. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

RPHS Law – Fisnik Salihu
(Emri i avokatit)

Rr. Major Mehmet Bushi, H6/Nr.5, Bregu i Diellit, 10000 Prishtinë, Kosovë.
(Adresa e plotë)

049525222
(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

fisnik.salihu@rphs.law, info@rphs.law.
(Adresa elektronike)

AVOKATIA • LAW FIRM
RPHS LLC
NUI: 810843989

23 Nëntor 2020
(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Më datë 19.06.2020 - Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), publikoi Dosjen e Tenderit në platformën e E-prokurimit në KRPP, me titull "Furnizim me llamarinë, me gypa rrethor dhe katror të çelikut për Korporatën Energjetike të Kosovës për Aktivitetin e Prokurimit me numër KEKO-20-237-121" (tutje referuar si "Aktiviteti i prokurimit").

Në këtë rast kemi të bëjmë me Kontratë Publike për Furnizim dhe tenderi zhvillohet në procedurë të hapur, ku kriter për dhënien e tenderit është Tenderi i Përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve/ofertave nga ana e Operatorëve Ekonomikë të interesuar, siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit, është më datë 03.08.2020, në orën 12:00. Ndërsa, afati i fundit për sqarimin e dosjes së tenderit është më datë 13.07.2020.

Më datë 16.11.2020 – Operatori Ekonomik "Euro - Commerce" ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim, në formë elektronike.

Më datë 17.11.2020 - Autoriteti Kontraktues ka publikuar Vendimin Nr. 10200, përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar Kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur nga Operatori

Ekonomik "Euro - Commerce".

23.11.2020 – Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues, Operatori Ekonomik "Euro Commerce" paraqet këtë Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Kjo ankesë parashtrohet para datës së hapjes së ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Më datë 16.11.2020 OE "Euro - Commerce" ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pas pranimit tw Letrws Standarde pwr Tenderuesin e Eliminues, me datw 11.11.2020. Me këtë rast, pretendimet e OE "Euro - Commerce" kanë qenë te bazuara dhe kanë pasur për qëllim evitimin e shkeljeve të shfaqura në lidhje me specifikimet teknike të paraqitura në Dosjen e Tenderit.

Me datë 17 Nëntor 2020, Autoriteti Kontraktues nxjerrë Vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga ana e OE "Euro - Commerce".

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Vendimi për refuzim si të pabazuar të Kërkesës për Rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "Euro - Commerce" është vendim i kundërligjshëm dhe në shkelje të rëndë të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (tutje referuar si "Ligji për Prokurimin Publik" ose "LPP").

Nenet specifike të shkelura nga ana e Autoritetit Kontraktues përfshijnë dsipozitat e LPP si në vijim:

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - përmes eliminimit të Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm nga Aktiviteti i Prokurimit, dhe shpërblimi me kontratë i Operatorit Ekonomik të papërgjegjshëm, dëmton rëndë jo vetëm Autoritetin Kontraktues, por, edhe buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi – Autoriteti Kontraktues është i obliguar që asnjë kërkesë, kriter, apo specifikim, që nuk është i saktësuar në Dosjen e Tenderit, të mos e përdorë në procesin e përzgjdhjes ose dhënies. Po ashtu, Neni në fjalë përcakton që Operatorët Ekonomik duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe që Autoriteti Kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në atë mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

Neni 28 - Specifikimet teknike - Autoriteti Kontraktues obligohet t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - Oferta e Operatorit Ekonomik "Euro - Commerce" është tërësisht e përgjegjshme. Arsyetimi i dhënë nga AK për eliminimin e të njëtit nga Aktiviteti i Prokurimit është në tërësi në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke qenë se i njëjti i përmbushë të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës - Me eliminimin e Operatorit Ekonomik "Euro - Commerce", Autoriteti Kontraktues ka kryer shkelje të Nenit 60, për shkak se nuk është zgjedhur ofertuesi me çmimin më të ulët dhe tenderi ekonomikisht më i favorshëm në përputhje me Dosjen e Tenderit.

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale - Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Operatorët Ekonomik të sigurojnë dëshmi, të tilla si certifikatat e hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuara që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse. Kjo për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin e Kontratës.

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kjo Ankesë dorëzohet në përputhje me Nenin 109 të LPP-së, kundër Vendimit të datës 17.11.2020 të AK, përmes të cilit është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE "Euro - Commerce".

Vendimet e tilla janë të kundërligjshme dhe në shkelje të rëndë të LPP-së dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, për arsyet të cilat do t'i elaborojmë në vijim të kësaj Ankese.

Më konkretisht, kundërligjshmëria e Vendimeve konsiston në faktet se: A) Certifikata ISO 9001 e ofruar nga OE "Euro - Commerce" është në përputhshmëri me kriteret e Dosjes së Tenderit; dhe se A) oferta e OE "Euro - Commerce" është ofertë e përgjegjshme e cila për AK-në ofron produktet të avancuara dhe me standardet më të larta teknike dhe të sigurisë.

PRETENDIMI ANKIMOR 1:

A. CERTIFIKATA ISO 9001:2015 E OFRUAR NGA OE "EURO - COMMERCE" ËSHTË NË PËRPUTHSHMËRI ME KRITERET E DOSJES SË TENDERIT

Sipas përshkrimit zyrtar në faqen zyrtare të Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit, ISO 9001:2015 është standard që përcakton kriteret për sistemin e menaxhimit kualitativ, me ç'rast kompania që e posedon certifikatën, në rastin konkret OE "Euro - Commerce", ka demonstruar a) aftësinë e saj për të siguruar produkte dhe shërbime të cilat i plotësojnë kërkesat ligjore dhe rregullative të klientit, dhe b) synimin për rritjen e kënaqësisë së

klientëve të saj përmes zbatimit efektiv të sistemit.

Ky standard bazohet në numër të caktuar të parimeve të menaxhimit kualitativ, përfshirë fokusin e shtuar për konsumatorët, motivimi dhe përfshirja e menaxhmentit të lartë të kompanisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve në kompani.

Kriter për lëshimin e Certifikatës ISO 9001:2015 është sistemi i brendshëm i menaxhimit kualitetiv dhe jo shërbimi apo produkti i caktuar që ofron një kompani.

Rrjedhimisht, Certifikimi ISO 9001:2015 i ofruar nga nga OE "Euro - Commerce" lidhur me të gjithë veprimtarinë e kompanisë dhe nuk është lëshuar për fusha të caktuara të aktivitetit afarist apo për produktet specifike që i ofron OE në fjalë.

Për më tepër, në rast të paqartësive lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë informata sqaruese nga Operatorët Ekonomik. Më konkretisht, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Operatorët Ekonomik që të sigurojnë dëshmi përmes të cilave dëshmohet se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin e Kontratës.

Rrjedhimisht, mbi bazën e të lartcekurave, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se Certifikata ISO 9001:2015 i ofruar nga OE "Euro - Commerce", i takon fushës së tregtimit dhe jo prodhimit, është i gabuar dhe nuk qëndron.

PRETENDIMI ANKIMOR 2:

A. OFERTA E OE "EURO - COMMERCE" ËSHTË OFERTË E PËRGJEGJSHME

Pretendimi i Autoriteti Kontraktues se Certifikata ISO me të cilën është certifikuar OE "Euro - Commerce", është certifikatë e cila i takon fushës së tregtimit nuk qëndron. Ky vlerësim është tërësisht i gabuar dhe nuk merr parasysh Certifikatën ISO 9001:2015 të bashkëngjitur, e as natyrën e saj e cila përputhet në tërësi me kërkesat në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, duke qenë se një pretendim i tillë nuk është i bazuar, atëherë, Autoriteti Kontraktues nuk mund të eliminojë OE "Euro - Commerce" mbi atë bazë - kinse ka ofruar Certifikatë e cila nuk përputhet me kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Në këtë drejtim, duke qenë se OE "Euro - Commerce" ka ofruar Certifikatën në fjalë, e cila është në përputhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit, lë të kuptohet se oferta e paraqitur nga OE është ofertë e përgjegjshme. Prandaj, Vendimi përmes të cilit është eliminuar OE "Euro - Commerce" nga Aktiviteti i Prokurimit është Vendim i

kundërligjshëm dhe si i tillë, duhet të anulohet.

Eliminimi i OE "Euro Commerce" është tendencioz dhe i kundërligjshëm për shkak se oferta e OE në fjalë nuk është analizuar mirë, në veçanti Certifikata ISO 9001:2015 - e cila në tërësi përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të Dosjes së Tenderit.

Përfundimisht, oferta e paraqitur nga OE "Euro - Commerce", përveç që është ofertë e përgjegjshme pasi që i përmbushë të gjitha kriteret / kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, e njëjta ofron edhe produktet më të avancuara dhe me standardet më të larta teknike dhe të sigurisë. Për këto arsye, oferta e OE në fjalë duhet të vlerësohet si e përgjegjshme, ndërsa Vendimi përmes të të cilit OE "Euro - Commerce" është eliminuar nga Aktiviteti i Prokurimit duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Prandaj, duke u bazuar në argumentet e lartcekura dhe shkeljet e elaboruara më lart, OE "Euro - Commerce", me respekt, kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që të marrë këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik "Euro - Commerce".

II. **ANULOHET** Vendimi i Autoriteti Kontraktues, i datës 17.11.2020, përmes të të cilit është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur nga Operatori Ekonomik "Euro - Commerce", dhe lënda kthehet në rivlerësim tek Autoriteti Kontraktues.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Në rast të aplikimit të kritereve diskriminuese dhe që kufizojnë konkurencën e drejtë, OE "Euro - Commerce", është i detyruar të veproj në mbrojtje të interesave të saj tij ekonomike dhe juridike duke kërkuar kompenzimin e plotë të dëmeve të shkaktuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*